



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 98/17, 105/17
Datë/Datum. 31.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY**

**PSH Nr. 98/17
105/17**

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Lgjin Nr. 05/L-068 dhe Lgjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej: Nuhi Paçarizi - Kryetar, z.Goran Milenovic – Referues, z.Ekrem Salihu – Anëtar, z Blerim Dina, z.Tefik Selejmani – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “2Agroup& G.P.G Company” sh.p.k - me seli në Prishtinë me nr te protokollit 98/17, dhe OE “Renelual Tahiri”- me seli në Prizren, me nr te protokollit 105/17, kundër Njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit të datës 24.03.2017, nga ana e autoritetit kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Asfaltimi i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë”, me nr. prokurimi:MI 16/050/511, me datë: 23.05.2017 mori këtë :

V E N D I M
MBI APROVIMIN TË ANKESËS SË OE “2A GROUP” SH.P.K – PRISHTINË, DHE
HUDHJEN POSHTË TË ANKESËS OE “RENELUAL TAHIRI” – PRIZREN, TË DATËS:
08.04.2017 DHE 11.04.2017.

- I. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE 2A Group” sh.p.k & G.P.G Company” sh.p.k- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull “Asfaltimi i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë”, me nr prok: ‘MI 16/050/511’, iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Infrastrukturës/.

- II. Hudhet poshtë**, si e palejuar ankesa e OE NPN “Renelual Tahiri” – Prizren, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull “Asfaltimi i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë”, me nr prok: ‘16/050/511. iniciuar nga autoriteti

kontraktues /Ministria e Infrastukturës/.

III. Anulohet, vendimi i AK-së /Ministria e Infrastukturës/, për anulim të aktivitet të prokurimit, me titull “Asfaltimi i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë”, me nr prok:“16/050/511” dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konformë dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së Nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

V. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

VI. Operatorëve ekonomik ankues OE N.P.N “Renelual Tahiri”- Prizren, dhe OE “2A Group sh.p.k & G.P.G Company” sh.p.k -Prishtinë, ju kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik NPN “Renelual Tahiri” sh.p.k- Prizren, si palë e pa-kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 05.04.2017, kundër Njoftimit për eliminim të datës 24.03.2017, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave: 1,6,7,59,60,62 dhe 72 të LPP-së.

Operatori Ekonomik “2A Group sh.p.k & G.P.G Company ” sh.p.k- Prishtinë, si palë e pa-kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 11.04.2017, kundër Njoftimit për eliminim të datës 24.03.2017, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave: 1,7,28,52,56,59,60 dhe 69 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113.1 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të pales ankimore, të OE N.P.N “Renelual Tahiri”, me seli në Prizren, si dhe OE “2A Group sh.p.k & G.P.G Company ” sh.p.k- Prishtinë

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të Aprovoj PJESËRISHT si të bazuar ankesën e OE ankues “2A GROUP SH.P.K&GPG COMPANY SH.P.K”, me seli në Prishtinë, njëherit të HUDHË POSHTË si të palejuar ankesën e OE-ve ankues “RENELUAL TAHIRI”, për këtë aktivitet të prokurimit: “Asfaltimi

i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë", me nr. prokurimi: MI-16-050-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastrukturës.

Eksperti shqyrtues njëherit REKOMANDON Panelin shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit të ANULOHET në tërësi në munges se asnjëri nga OE pjesëmarrës NUK kanë përbushur në përpikëri kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për konrat.

Me datë 25.04.2017, OE ankues "Renelual Tahiri" përmes parashtresës me shkrim informon OSHP, se nuk pajtohet me raportin ekspertit shqyrtues.

Me datë 25.04.2017, OE ankues "2A Group sh.p.k & G.P.G Company" sh.p.k, përmes parashtresës me shkrim informon OSHP, se nuk pajtohet me raportin ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues me datë 02.05.2017, përmes parashtresës me shkrim informon OSHP, se pajtohet me raportin ekspertit shqyrtues.

Në seancen e dt.23.05.2017, të mbajtur në OSHP. Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës në ora 11:35, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit OE-ve, përfaqësuesi i AK-së, si dhe eksperti shqyrtues.

Në vazhdim të seances kryetari i panelit fjalën iu dha përfaqësuesit të OE "Renelual Tahiri" z.Veseli i cili deklaroj: "qënrojmë në tërësi pranë pretendimeve ankimore tona, konsiderojmë se arsyet e AK-së janë të papranushme sipas LPP-së. Ne kemi kërkuar interpetim prej KRPP-së për të quartesar në cilat raste mund të anulohet një aktivitet bazua në papërgjigjshmërinë e OE-ve, dhe të njëjtin inpretetim i kemi bashaknjitur OSHP-së. Mendojmë se nuk ka asnjë bazë ligjore për anulimin e këtij vendimi duke thirrur në mungesë të OE-ve të përgjegjshëm apo tre OE të përgjegjshëm në këtë fazë të procedurës ku kemi arritur. Ne gjithashtu nuk pajtohem me arsyetimin për ruajtje të parasë publike që kjo nuk qëndron, po ashtu nuk qëndron qëllimi parësor për zhvillim të ndëershëm të procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu kemi kundërshtuar ekspertizën e ekspertit ku rekomanodon se ky aktivitet të anulohet mbi arsyet e lartcekura, dhe kosniderojmë se është e pabazuar në ligj.

Kërkojmë nga OSHP të quartesoj një pyetje themelore të përsëritur në dy apo tri vendime, a e ka përjashtuar OSHP OE:"Renelual Tahiri" apo nuk e ka përjashtuar", kjo pyetje don përgjigje, për arsyet se nuk e dim a e ka përjashtuar apo shpall të papërgjegjshëm OSHP me vendimet e saja OE:"Renelual Tahiri" apo jo. Në asnjë pikë të vendimi të parë të dytë dhe konkusionit të OSHP nuk është vendos me dispozitiv se OE Renelual Tahiri është përjashtu nga aktiviteti i prokrimit.

Për këtë arsyet i propozojmë panelit që të plotësoj dy vendimet e marra më herët, cilat janë në kundërshtim me njëra tjetrën, sepse pjesa dispozitivit dhe arsyetimi janë të paqarta, të pakuptueshme dhe kundërthënëse njëra me tjetrën, dhe i propozojmë panelit që lëndën ta kthej në rivlerësim , të pranoj në tërësi ankesën e OE Renelual Tahiri, bashk me sqarimet lidhur me pyetjen që kemi parashtruar".

Në vazhdim fjalë iu dha përfaqësuesit të OE 2A GROUP, z.Ademi i cili deklaroj: "si fillim do dëshiroj të shpreh keqardhje që nëpër AK punojnë zyrtarë të tillë si Ushtruesi i detyrës së MI-së z.Besim Tahiri ku i njëjti po keqpërdor detyrën zyrtare për hakmarrje personale ndaj meje dhe kompanisë. Ne si OE për tretën herë jemi shpall të përgjegjshëm nga komisionet vlerësuese brenda MI-së për këtë aktivitet të prokurimit, dhe për dytën herë radhazi jemi rekomanuar për dhënie të kontratës nga dy komisione vlerësuese brenda MI-së për këtë aktivitet, dhe përsëri ky udhëheqës i prokurimit po keqpërdor detyrën për qëllim diskriminit tonë si OE, edhe pse me vendim të OSHP-së nr.398-401-403/16, janë faktuar shkelje se z.Tahiri si udhëheqës i prokurimit ka bërë, dhe ankesa jonë paraprake është vlerësuar si e bazuar nga OSHP dhe lënda përsëri është kthyer në Ri-vlerësim

dhe e njëjta është rivlerësuar përsëri nga komisioni brenda MI-së dhe për dytën herë rekomandohemi ne si OE për dhënie të kontratës.

Ky zotëri pësëri tenton të anuloj kete aktivitet me arsyetim se kinse ne si OE nuk kemi ptotësuar kërkesën e dosjes lidhur me mbështetjen bankare. Në bazë të vendimi të OSHP-së nr.398-401-403/16 përmes cilit është këruar nga AK-ja që gjatë fazës së rivlerësimit të vlerësohen dhe shqyrtohen ofertat e gjithë OE-ve se a përbushin kërkesën lidhur me mbështetje bankare, atëher dëshiroj të informoj panelin se kjo mbështetje është vlerësuar dhe shqyrtuar nga komisioni vlerësues dhe të njëjtë përmes raportit të vlerësimit të datës 25.01.2017, kanë kostatuar siq citoj “komisioni për rivlerësim ka vlerësuar mbështetjet bankare të OE-ve si kërkesë e OSHP-së dhe në bazë të vlerësimit të mbështetjeve bankare të OE-ve, komisioni vlerëson se mbështetja bankare e OE:”2A Grou&GPG Company”, është e plotësuar në bazë të njofitimit për kotnratë dhe dosjes së tenderit”. Këtë raport ia ofroj në shikim panelit si provë.

Përveq kësaj informoj panelin se ne si OE në të kaluarën jemi shpallur fitues në një aktivitet tjetër të prokurimit “ndërtimi i rrugës Vojnik – Osojan” nga po kjo Ministri , ku si kërkesë në dosje ka qenë që OE-të të kenë mbështetje bankare, madje kërkesa ati aktiviteti ka qenë identike me kërkesën me këtë aktivitet të prokurimit, dhe ne si OE kemi ofruar mbështetje bankare identike, si kjo që kemi ofruar për këtë aktivitet të prokruimit dhe jemi shpall fitues për atë aktivitet të prokurimit.

Andaj me qenë se këtu po vërehet qartë tendencia që Besim Tahiri ka për na diskriminuar neve si OE, dhe kur dihet qartë se ne si OE kemi ofertuar me një ofertën prej 1 milion euro më të lirë se parashikimi që vet AK-ja ka planifikuar për këtë projekt, atëher këkrojmë nga OSHP të detyroj këtë zyrtarë të heq dorë nga praktikat e tillë që po përdor dhe ta detyroj atë të vazhdoj me njofit për dhënie të kontratës konform rekomandimit të raportit të vlerësimit të datës 25.01.2017 , përmes cilit ne si OE jemi rekomanduar për dhënie të kotnratës.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-MI z.Tahiri cili deklaroj:

Më vjen keq që është seanc e dytë për këtë lëndë dhe paneli i OSHP lejon të përdoren fjalë të tillë. Pa dasht të lëshohem fell në këtë lëndë që besoj se është konsumuar edhe prej OSHP, do ndalem direkt te kërkesa mbështetjes bankare, për projektin që jemi këtu kërkesa ka qenë “mbështetje bankare pa kushte ose qasje në kredi pa kushte”. Njëjtën kërkesë si AK e kemi vlerësuar njëjtë, gjithë OE-të në vlerësimin e parë e kemi marr të pranueshme pasi ka qenë në gjitha përafërsisht përshkrimi i njëjtë.

Në rivlerësim kanë qenë ankesat e po këtyre OE-ve që janë ankuar në mbështetje bankare të OE në konzercium Beni com & Gerlica, dhe ka qenë vendimi i po këtij paneli të OSHP-së i datës 09.12.2016 PSH.nr.398-401-403/16, dhe konkluzioni i datës 30.12.2016 nr.PSH.nr.398-401-403/16, i cili panel ka vendos që mbështetja bankare e OE të rekomanduar Beni Com& Gerlica nuk plotëson kërkesën e dosjes për mbështetje bankare, po sipas këtij vendimi është kthyer lënda në Rivlerësim dhe gjatë procesit të rivlerësimit tretë si AK vetëm se kemi zbatuar drejt vendimin dhe konkluzionin e panelit të OSHP.

Në këtë pikë gjithë OE-të kanë ofruar mbështetje bankare të ngjashme, dhe në mungesë të ofertave së paku një ofertë të përgjegjshme e njëjta lëndë është marr vendim të anulohet.

Andaj si AK qëndrojmë pranë vendimit tonë për anulimin e këtij proesi si dhe ekspertizës së ekspertit i cili ka dhënë mendimin në këtë lëndë.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Fazliu i cili deklaroj:

Lidhur me pretendimin për OE “2A Group&GPG”, dua ti prezantoj panelit letër përkrahjet e ofruara, ky OE ka ofruar këtë dokument Letër përkrahje nga banka e cila mund të them se është më e plotësuar e kompletuar me OE-tjerë ofertues ku në letër përkrahje të këtij OE paragrafi fundit shkruan “Aplikanti 2A Group shpk ka kapacitet të majftueshme financiare dhe banka në të ardhmen mund ta përkrah me kredi, letër kredi, garacion bankar, sa i pëket këtij projekti të prokurimit” ku citohet titulli dhe numri i prokurimit. Poashtu me gjithë se nuk ka qenë pjesë e

ankesës, dokumenti që ka ofruar ky OE dhe kërkesa e AK-së për projektet parapraka janë të njëjta.

Paneli shqyrtues është kompetent të shqyrtoj këtë dokument duke pas parasyshë paragrafin 2 të kësaj letre qka shenohet aty nga banka. Në raport të ekspertizës si ekspert nuk kam dashur të përshkruem si avokat i OE “2A Group” dhe për këtë kam lënë ta prezantoj para panelit pasi paneli është kompetent të vlerësoj këtë dokument. I sqaroj panelit se zyrtari kryesor i prokurimit të MI-së me arsyen e anulimit të këtij aktiviteti dhe eleiminimin e OE “2A Group” ka cek se letra përkrahje është e njëjtë si OE paraprakisht të rekomanduar për kontratë “OE Gerlica”, gjatë ekzaminimit të këtyre dy dokumenteve që i prezantoj edhe panelit për krahasim, këto dy dokumente nuk janë të njëjta, sepse Letër përkrahja e lëshuar për Gerlica Company shpk në paragrafin e parë lëshuar nga BKT për këtë OE thuhet se “OE është klient i bankës dhe i njëjtë ka të aprovuar limit përmjet 100.000€”. ky paragraf bie poshtë pasi nuk ka të bëjë aspak me kërkesë të dosjes pasi me dosje është kërkuar depozit apo lejim i kredisë me vlerë 200.000€, ndërsa vazhdon më tutje “gerlica company” i plotëson gjitha konditat ndaj BKT për produkte bankare si garancion bankarë, ose kredi, dhe nëse kompania dëshmon të jetë e suksesshme dhe të fitoj tenderin, BKT do mbështet kompaninë me garancion adekuat bankarë apo me forma të tjera mbështetëse financiare nëse kompania i plotëson kriteret e nevojshme në bazë të procedurave të bankës. Kjo nënkupton se ky dokument është kundërthënës në vet vetë nga banka dhe nuk dëshmon se plotëson kriterin kjo kompani, dhe i njëjti dokument nuk përbën as titull të aktivitetit, as numrin e aktivitetit, si dhe nuk përbën as shumën e kërkuar përmblim. Do duhej të plotëson së paku njëren nga këto kërkesa, dhe i njëjti është kontraditor, pasi në pjeën e parë thotë se do e mbështesin, dhe pjesën tjetër thotë nëse plotëson kushtet e bankës.

I propozoj panelit që të ketë parasyshë këto dy dokumente të dy OE-ve të ndryshëm gjatë marrjes së vendimit lidhur me ankesën e OE “2A Group”.

Sa i përket ankesës së OE Renelual Tahiri, kam cek edhe në raport se e njëta është shqyrtuar nga paneli dhe për njëtin është marrë vendim disa here ku kemi trajtuar si rast i gjykuar.

Lidhur me pikën përinjësin e inixhinier-deklarata nën betim, kjo është arsyja pse është shpall i papërgjegjshëm ky OE.

Anëtari i panelit z.Salihu pyeti përfaqësuesin e AK-së se komisioni rivlerësues a e ka trajtuar qështjen e mbështejteve bankare konform rekomandimeve të panelit shqyrtues të OSHP, pasi nga sa pamë në raport të komisionit rivlerëues kanë pas parasyshë dokumentet përmblim.

Në përgjigje z.Tahiri deklaroj:

JO, komisioni i rivleresimit numër tre nuk ka shqyrtuar mbështetjet bankare sipas vendimit të OSHP-së, ku jam detyruar prap që rekomandimin e komisionit ta hujhe poshtë dhe me vendim sipas kompetencave ligjore të zbatoj drejt vendimin e OSHP-së të datës 09.12.2016 me numër PSH.nr.398-401-403/16 si dhe konkluzionin e datës 30.12.2016 numër PSH.nr.398-401-403/16, vendim i cili OE Beni Com & Gerlica për njëtin përshkrim, njëjtën arsyen, e qet me vendim të papërgjegjshëm dhe si AK vetëm se kemi zbatuar vendimin e këtij paneli. Gjithashtu mbështetjet bankare përshkruajnë sakt kushtet, dhe për këtë arsyen fillimisht nuk kemi eliminuar asnjë OE.

Anëtari i panelit z.Salihu pyeti përfaqësuesin e AK-së se me rastin e anulimit të raportit të komisionit rivlerësues a i jeni drejtuar bankës përmarrje të sqarimit konkret.

Në përgjigje z.Tahiri deklaroj:

Nuk i jemi drejtuar bankës pasi kemi zbatuar drejt vendimin e OSHP-së.

Anëtari i panelit z.Sylejmani pyeti përfaqësuesin e AK-së se sa është vlera parashikuar përmblim.

Në përgjigje z.Tahiri deklaroj:

Vlera parashikuar ka qenë rreth 2.9 milion euro.

Anëtari i panelit pyeti ekspertin shqytues se sipas jush garancioni bankar i OE “2A grup” a është i përgjegjshëm për këtë dosje.

Në përgjigje z.Fazliu dekalroj: për këtë arsyе prezatova para panelit dokumentet në fjalë, arsyеja pse nuk kam paraqitur në ekspertizë është se nuk ka pas shumën e cekur, mirëpo vetëm emrin dhe numrin e aktivitetit, dhe në raport e kam cek se nuk është e plotësuar në përgjithësi dhe kam dashtë të trajtoj para palëve, sipas pasusit të dytë të kësaj letre OE ka kapacitetet e mjaftueshme financiare, dhe sipas meje nënkuption se për njëjtën kërkesë mund të mbuloj me kapacitetin që ka.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE:“Renelual Tahiri” z.Veseli deklaroj:

Ne i propozojmë panelit që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE:“2A Group&GPG” z.Ademi deklaroj:
Të aprovohet ankesa dhe të mbete në fuqi vendimi i komisionit vlerësues.

Në fund përfaqësuesi i AK z.Tahiri deklaroj:

Kërkojmë nga panelit shqyrtues të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Në vazhdim eksperti shqyrtues z.Fazliu deklaroj:

qëndroj pranë konstatimeve të dhëna në seancën e sotme për shqyrtim kryesor.

Paneli shqyrtues në lidhje me ankesën e parashtruar nga ana e OE ankues “Renelual Tahiri”, konstaton se e njëjtë hudhet poshtë si e pa-lejuar pasi që i njëjtë OE ankues në fjalë është shpallur radhazi i papërgjegjshëm me vendim të OSHP-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit sa i përket kriterit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat në lidhje me kërkesën për “deklaraten nën-betim të inxhinierave se të njëjtit nuk janë të angazhuar edhe në projekte të tjera në MI”.

Paneli shqyrtues, pas analizimit dhe shoshitjes së provave konstatoj se ankesa e OE 2A Group sh.p.k, është e bazuar përfaktin se me rastin e rivlerësimit pranë AK-së, komisioni rivlerësues ka vepruar konform vendimit të fundit të panelit shqyrtues dhe i njëjti në raport të rivlerësimit ka konstatuar se OE 2A Group sh.p.k, i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret sipas njoftimit për kontrat dhe dosjes së tenderit dhe gjithashtu komisioni i fundit rivlerësues në raportin e tij ka konstatuar se OE 2A Group sh.p.k, ka ofruar mbështjetje bankare konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Gjithashtu paneli shqyrtues konstaton se duke u mbështetur në paragrafin e tretë të mbështjetjes bankare të ofruar nga OE 2A Group sh.p.k, kunënkuption se OE 2A Group sh.p.k, ka kapacitet të mjaftueshëm financiar konform kërkesës së dosjes së tenderit përkitazi me këtë aktivitet prokurimi se mbështetja bankare përmban titullin e aktivitetit të prokurimit dhe numrin e prokurimit dhe se Banka paraprakisht para lëshimit të këtij dokumenti ka qenë e njoftuar me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat si dhe për shumen e kërkuar nga ana e AK-së, përfaktë aktivitet të prokurimit dhe se paragafi i tretë i këtij dokumenti në mënyr shprehimore nënkuption se OE në fjal gjzon mbështetje bankare në shumën e kërkuar përfaktë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se vlen të theksohet se Autoriteti kontraktues MI të njëjtin OE 2A Group sh.p.k, e ka shpërbllyer me konrat për aktivitetin e prokurimit me nr.MI 15-048-511, dhe në dosjen e tenderit për kete aktivitet të prokurimit kërkesa për mbështjetje bankare ka qenë identike me aktivitetin për të cilin kontestohet kjo mbështetje bankare dhe AK-ja po me të njejtën mbështetje bankare e ka nënshkruar kontratën me OE 2A Group sh.p.k.

Poashtu paneli shqyrtues konstatoj se zyrtari i prokurimit pa dhën asnjë arsy e ka anuluar rekomandimin e komisionit ri-vlerësues dhe po i njëjti zyrtar i prokurimit edhe gjatë seances dëgjimore nuk ofroj panelit shqyrtues asnjë dëshmi materiale përmes së ciles dota kontestonte validitetin e mbështetjes bankare të këtij OE 2A Group sh.p.k, për këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj, paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin:117 të LPP-së dhe atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mundë të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesëpadi në Departamentin për çështje administrativ
pranë Gjykatës Themelore.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Nuhri Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1. 1x1 AK – “Ministria e Infrastukturës”.
2. 1x1 OE “Renelual Tahiri”.
3. 1x1 OE “2Agrou & G.P.G Company”
4. 1x1 Arhivës së OSHP-së